



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.523/2023

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve (KS) Frende Forsikring, 3600 Fyllingsdalen N-5845 Bergen, Norvegji, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokateve ICS Assistance LLC me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, Lagja Dardnia, Bll. 1A, nr.21-23, avokat B.N., kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve Sigma me seli në Prishtinë, Rr.“Pashko Vasa” qytetëza Pejton, me objekt kontesti shpërblim dëmi mbi bazën e subrogimit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KE.nr.302/2022 të datës 26.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET Pjesërisht ankesa e autorizuarit të paditësit Kompania e Sigurimeve (KS) Frende Forsikring, 3600 Fyllingsdalen N-5845 Bergen, Norvegji, NDRYSHOHET pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KE.nr.302/2022 i datës 26.01.2023, sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës dhe çështja gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve Sigma me seli në Prishtinë, t’ia kompensojë paditësit Frende Forsikring me seli në Norvegji të gjitha shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, dhe atë në lartësinë 8,561.4 Euro, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit -plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa shpenzimet tjera mbi shumën e gjykuar refuzohen si të pabazuar.

II. REFUZOHET si e pabazuar ankesa autorizuarit të paditurit Kompania e Sigurimeve Sigma me seli në Prishtinë, Rr.“Pashko Vasa” qytetëza Pejton, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, KE.nr.302/2022 i datës 26.01.2023 sa i përket pikës I dhe II të dispozitivit, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik me aktgjykimin KE.nr.302/2022 të datës 26.01.2023, ka vendosur si në vijim: “ I. Aprovohet në tërësi e bazuar padia e paditësit KS Frende Forsikring me seli në Norvegji e datës 26.04.2016 parashtruar kundër të paditurës KS Sigma me seli në Prishtinë, për shpërblim dëmi mbi bazën e subrogimit nga aksidenti i datës 06.03.2015. II. DETYROHET e paditura KS Sigma me seli në Prishtinë që në emër të regresit nga sigurimi kasko i automjetit t’ia paguajë paditësit KS Frende Forsikring me seli në Norvegji shumën 16’294.41 € (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër euro e dyzet e një cent) me kamatëvonesë 8 % e llogaritur nga data 30.03.2015 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. III. Detyrohet e paditura KS Sigma me seli në Prishtinë, t’ia kompensojë paditësit Frende Forsikring me seli në Norvegji të gjitha shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, dhe atë në lartësinë 4’343.40€ (katërmijë e treqind e dyzet e tre euro e dyzet cent) në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në emër të kërkesës Casko Regres për paditësin të gjykoj shumën 6,133 Euro, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi këtë shumë ta refuzoj si të pabazuar apo aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t’ia kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditurit, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurit me propozim të refuzohet si e pathemeltë ankesa.

Ankesë kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur edhe i autorizuari i paditurit, vetëm sa i përket pikës III të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, me propozim që të miratohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në pikën III të dispozitivit, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 9,425.90 Euro.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditurit është e pabazuar.

Ankesa e autorizuarit të paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Kompania e Sigurimeve (KS) Frende Forsikring, 3600 Fyllingsdalen N-5845 Bergen, Norvegji, me datë 26.04.2016, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit në emër të regresit nga sigurimi kasko, kundër të paditurit Kompania e

Sigurimeve Sigma me seli në Prishtinë, Rr.“Pashko Vasa” qytetëza Pejton, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të regresit nga sigurimi kasko i automjetit t’ia paguajë paditësit shumën prej 17,883.38 € me kamatëvonesë 12 % e llogaritur nga data 30.03.2015 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, fillimisht ka nxjerrë aktgjykimin IV.EK.nr.233/2016 të datës 09.11.2018, me të cilin ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të njëjtë. Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse, me aktvendimin Ae.nr.304/2018 të datës 12.12.2019, ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka prish aktgjykimin IV.EK.nr.233/2016 të datës 09.11.2018 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën e rishqyrtimit, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë pas vlerësimit të provave të administruara ka marr aktgjykimin KE.nr.302/2022 të datës 26.01.2023, me të cilin ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar se i njëjti mbi bazën e subrogimit kërkon rimbursimin e dëmit me kamatë vonese , kjo për faktin se nga policës së sigurimit AutoKasko me nr. 3026654, konstatohet se vetura e aksidentuar e tipit ËE Multivan – viti i prodhimit 2004 me targa Norvegjeze – Targa, ka qenë e siguruar nga paditësi për periudhën 01.03.2015 – 01.03.2016. Pronari i veturës A.K. ka pësuar aksident trafiku në Kosovë – Prishtinë, Lagjja Veternik, e cila përshkruhet sipas Raportit të aksidentit në trafik, dhe nga ky raport konstatohet se aksidenti është shkaktuar nga vetura / Kamioni MAN me targa ... i cili ka qenë i siguruar tek e paditura si në këtë çështje. Gjykata ka theksuar se i padituri nuk e ka kontestuar bazën juridike të rimbursimit të paditësit, mirëpo ka kontestuar lartësinë e vlerës së kërkuar.

Tutje gjykata ka arsyetuar se duke marr për bazë udhëzimet e gjykatës së shkallës së dytë, i ka ballafaquar dy ekspertizat, super ekspertizën e punuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Dr.sc.A.K., Dr.sc. Sh.L. dhe Dr.sc.H.D. dhe ekspertizën e ekspertit të makinerisë–S.B. dhe si përfundim gjykata i fali besimin ekspertizës së ekspertit të makinerisë–S.B. si profesionale dhe e punuar konform dispozitave ligjore, me arsyetimin se e njëjta pasqyron informacione burimore dhe grafikone shpjeguese reale për përdorimin dhe amortizimin e veturës së aksidentuar, së cilës ndër vite i bie vlera ekonomike, andaj edhe sasia e dëmit të shkaktuar në veturë ka qenë aq e lartë sa do të mund të riparohet vetëm nën një kosto të lartë dhe me profesionizëm të lartë që si përfundim mund të thuhet se “*nuk ia vlen*” për riparim.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se vendimin e saj për aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë e ka mbështetur në dispozitat e nenit 136.1, 159.1, 169.1, 174, dhe 281 lidhur me nenin 690.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), si dhe në bazë të nenit 25 dhe 26 të Ligjit për sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Lidhur me këmbimin e vlerës së kalkuluar nga eksperti S.B., nga Kruna Norvegjeze (NOK) në valutën Euro (Euro), gjykata e përcaktoi këmbimin në bazë të kursit valutor të datës së shqyrtimit kryesor gjyqësor 19.01.202 , e cila rezultoi në shumën e përcaktuar si në piken II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj lidhur me kamatën e ka mbështetur në nenin 382.2 të LMD-së, e lidhur me mendimin juridik të Gjykatës Supreme për caktimin dhe llogaritjen e kamatës, pika VI dhe X., ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së, ndërkaq lartësinë e kërkesës e ka caktuar sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, nr. tarifor 6 dhe 7.

Gjykata e Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësojnë së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, me përjashtim të vendimit mbi shpenzimet e procedurës që është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 453 të LPK-së, për çka u deshtë që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të vendoset si dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadisë në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka provuar përmes ekspertizës, konkretisht ekspertizës së punuar nga eksperti i makinerisë S.B..

Gjykata ankimore, po ashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të

kërkesëpadisë për faktin se në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 06.03.2015 sipas raportit të Policisë nr.2015-AD-0717, është automjeti, kamioni i makrës “Man” me targa të regjistrimit ... që kishte të kontraktuar sigurimin me të paditurin sipas policës së sigurimit nr.0005125092 të dt.05.06.2015. Në bazë të ekspertizës së makinerisë të punuar nga eksperti S.B., është përcaktuar lartësia e kompensimi të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurit, të cilës ekspertizës gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka falur besimin, pasi që edhe sipas kësaj gjykate ekspertiza në fjalë është punuar në mënyrë profesionale, përllogaritja e lartësisë së dëmit është bërë konform dispozitave ligjore, konkretisht rregullores së BQK mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensim të dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia neni 8 paragrafi 2, pika g).

Gjykata ankimore ka vlerësuar pretendimet e autorizuarit të paditurit se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka qenë dashur që të merret për bazë super ekspertizën e punuar nga grupi i eksperteve Dr.sc.A.K., Dr.sc. Sh.L. dhe Dr.sc.H.D., mirëpo të njëjtat rezultojnë si të paargumentuar, për arsye se nga provat shkresore shihet se vlerësimi i eksperteve në super ekspertize nuk është i besueshëm dhe i arsyetuar, të njëjtit me rastin e punimit të kësaj ekspertize nuk janë mbështetur në kornizën ligjore të rregullores së BQK-së mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensim të dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësi. Prandaj, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 paragrafi 1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi”*.

Kolegji i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës në lidhje me llogaritjen e vlerës së dëmit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për arsye se nga dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 pika g të BQK-së i cili përcakton se: *“dëmi në mjetin motorrik të dëmtuar me targa të huaja mund të pranohet në bazë të faturës së riparimit të bërë në vendin e regjistrimit të mjetit motorrik duke bërë krahasimin e atij riparimi me procesverbalin mbi dëmin”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerë reale të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës, lartësia e të cilit është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit, me të cilën janë konstatime të mbështetura në prova që gjenden në shkresat e lëndës, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka pranuar çmimet e llogaritura sipas vlerave të vendit të regjistrimit, të cilat në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, sepse të njëjtat pretendime janë ngritur edhe para gjykatës së shkallës së parë, por gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, dhe për të

gjitha çështjet kontestuese ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, me të cilat pajtohet plotësisht edhe kolegji i kësaj gjykate.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të dy palëve ndërgjyqëse, vlerësoi se pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit janë tërësisht të pabazuar, të paargumentuar dhe pa ndikim për të vërtetuar një gjendje tjetër faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar ligjin material kur ka vërtetuar se i padituri mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit mbi bazën e subrogimit ndaj paditësit, meqenëse i siguruari i të paditurit ka shkaktuar dëmin. Ndërsa pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës gjykata ankimore i ka marr pjesërisht të pranueshme në bazë të argumenteve që ka provuar pala paditëse, andaj kolegji i kësaj gjykate në mbështetje të nenit 201 pika b) të LPK-së, vendosi ta ndryshoj aktgjykimin ankimor, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, aprovoi pjesërisht pretendimet e autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar në pikën III të dispozitivit sa i përket shpenzimeve të procedurës është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit nuk ka marr për bazë listën e shpenzimeve të datës 19.01.2023 të cilën e ka prezantuar i autorizuari i paditësit. Nga shkesat e lëndës, kolegji vlerëson se të autorizuari të paditësit duhen t'i njihen shpenzimet e procedurës kontestimore si vijon: për pagesën e taksës për padi 149.00 Euro, për pagesën e taksës për ankesë 30,00 Euro, për ekspertizë të makinerisë 150,00 Euro, për përpilimin e padisë 416,00 Euro, për përpilimin e parashtrësive të datës 22.01.2018, 15.02.2018, 15.10.2021, 25.01.2022 dhe 26.01.2022 shumë prej 1,040.00 Euro, për përfaqësimi në seancat e datës 14.04.2017, 02.06.2017, 07.07.2017, 13.02.2018, 28.05.2018, 26.06.2018, 06.09.2018, 16.11.2020, 06.12.2021, 25.01.2022, 21.03.2022 dhe 19.01.2023 në shumë prej 5.944.40 Euro, për përpilimin e ankesës së datës 29.11.2018 shumë prej 832.00 Euro, gjithsej shuma e përgjithshme 8,561.4 Euro, të cilat shpenzime gjejnë mbështetje në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë në nr. tarifor 6, 7, 9 dhe nenin 449 e lidhur me nenin 453 të LPK-së.

Shpenzimet tjera mbi shumën e gjykuar të kërkuar nga i autorizuari i paditësit për taksën për padi 1,50 Euro dhe për taksë për ankesë 1,00 Euro, refuzohen si të pabazuar, për faktin se të njëjtat nuk janë dëshmuar me prova, pasi që nga urdhërpagesa e datës 13.05.2016 shihet se për taksën për padi është paguar vlera prej 149.00 Euro, ndërsa për taksën për ankesë nga urdhërpagesa e datës 26.11.2018 shihet se është paguar vlera prej 30.00 Euro.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195 paragrafi 1, pika e) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.523/2023, me datë 08.02.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari,
Ramush Bardiqi